



**USAID | KOSOVO**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr./ Br 996-1/22

Nr. i fq./ Br. st - 06 -

Data: / Datum 27. 07. 2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



Komuna e Vushtrisë  
Opština Vuçitrn  
Municipality of Vushtri

**MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT**

**NDËRMJET**

**DAI GLOBAL, LLC**

**DHE**

**KOMUNËS SË VUSHTRRIË**

**LIDHUR ME  
AKTIVITETIN PËR INTEGRITET TË KOMUNAVE TË KOSOVËS (KMI)**

Ky Memorandum i Mirëkuptimit (në tekstin e mëtejme "MM") është lidhur në këtë Ditë të 27-të korrikut 2022 (në tekstin e mëtejme, "Data e hyrjes në fuqi"), nga dhe ndërmjet DAI Global, LLC (në tekstin e mëtejme referuar si "DAI"), dhe Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme referuar si "Komuna"), së bashku të referuar si "Pjesëmarrësit" dhe secili veç e veç si "Pjesëmarrësi".

**DUKE QENË SE** DAI e ka si qëllim të bashkëpunojë me Komunën për zhvillimin dhe futjen në përdorim të një modeli për komuna etike, me integritet dhe llogaridhënese, për angazhimin e nivelit qendror për trajtimin e korrupsionit komunal në proceset e prokurimit, menaxhimit të kontratave, auditimit dhe menaxhimit financiar, dhe që t'i mundësojë shoqërisë civile ta gjurmtojë dhe ekspozojë korrupsionin në nivel komunal;

**DUKE QENË SE** DAI e ka si objektiv të bashkëpunojë me Komunën për rritjen e integritetit dhe llogaridhënies së Komunës në fushën e procesit të prokurimit, menaxhimit financiar, auditimit të brendshëm dhe menaxhimit të kontratave; dhe

**DUKE QENË SE** Komuna e ka si objektiv të bashkëpunojë me DAI-n për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies së procesit të prokurimit, menaxhimit financiar, auditimit të brendshëm dhe menaxhimit të kontratave nga Komuna; dhe

**TANI, PËR KËTO ARSYE**, Pjesëmarrësit synojnë të bashkëpunojnë së bashku në aktivitetet e mëposhtme:

## 1. QËLLIMI

Qëllimi i këtij memorandumi është formalizimi i bashkëpunimit ndërmjet DAI-t, kontraktorit që zbaton Aktivitetin për Integritet të Komunave të Kosovës të financuar nga USAID-i (në tekstin e mëtejme "Aktiviteti KMI"), dhe Komunës. Duke i koordinuar nga afër përpjekjet e DAI-t dhe Komunës në kuadër të këtij MM-je, të dyja organizatat synojnë t'i shfrytëzojnë burimet e tyre përkatëse që të arrihen ndikime që nuk do të mund të arriheshin individualisht. DAI dhe Komuna janë të përkushtuar ndaj parimeve të qeverisjes së mirë: sundimi i ligjit, transparenca, llogaridhënia, efizienz, efektshmëria, reagueshmëria, përfshirja dhe pjesëmarrja e qytetarëve. Andaj, Pjesëmarrësit e kanë nënshkruar këtë MM që të përcaktojnë veprimet e tyre të propozuara në lidhje me mbështetjen e tyre për këtë qëllim.

## 2. SFONDI

DAI është kontraktori që zbaton Aktivitetin KMI të financuar nga USAID-i, i cili është një projekt pesëvjeçar i dizajnuar për mbështetjen e Qeverisë së Kosovës (QK) në zbatimin e reformave kundër korrupsionit. DAI, përmes Aktivitetit KMI, planifikon të adresojë sfidat e kahershme në lidhje me korrupsionin dhe ofrimin e shërbimeve me cilësi të dobët nga Qeveria e Kosovës, duke përmirësuar menaxhimin e financave publike (MFP), me fokus në prokurimin komunal, dhe duke përforcuar mekanizmat e llogaridhënies brenda dhe jashtë qeverisë, përmes shoqërisë civile, sektorit privat dhe mediave, duke përmirësuar integritetin dhe llogaridhënien e procesit të prokurimit komunal në të 38 komunat e Kosovës, dhe duke ofruar ndihmë gjithëpërfshirëse për tetë komuna të fokusit. DAI planifikon të arrijë objektivat e aktivitetit KMI përmes mentorimit, trajnimit dhe stërvitjes së përditshme, dhe në këtë mënyrë do të

themelojë sisteme që synojnë të përmirësojnë llogaridhënien për fondet dhe shpenzimet publike.

### 3. FUSHAT E ASISTENCËS SË PLANIFIKUAR TEKNIKE

Aktiviteti KMI synon të adresojë nevojat e Komunës pas një vlerësimi të bazuar në Vlerësimin e Nevojave që u mbështet nga DAI. Asistenca specifike që do të ofrojë DAI përmes zbatimit të Aktivitetit KMI, do të specifikohet në Planin e Punës së Komunës, i cili do të dakordohet me Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë dhe DAI-n. Plani i Punës i Komunës përshkruhet në terma të gjera në nenin 4 të këtij MM-je.

### 4. ROLI I PLANIFIKUAR I DAI-t

DAI synon t'i ofrojë Komunës mbështetjen e mëposhtme:

- **Asistencë teknike të përshtatur** të ofruar përmes mentorimit dhe trajnimit në punë në lidhje me ciklin e prokurimit, duke përfshirë planifikimin e projektit, dizajnin dhe dokumentacionin e projektit, kërkesat e planifikimit, tenderimin, vlerësimin e ofertave, dhënien e kontratës, kontabilitetin dhe auditimin, menaxhimin e kontratës, informacionin elektronik, burimet elektronike, tenderimi elektronik, dhe të gjitha fushat e tjera të ciklit të prokurimit, duke vendosur në këtë mënyrë mekanizma mbrojtës kundër korrupsionit gjatë gjithë procesit.
- **Krijimi i mekanizmave** për rritjen e llogaridhënies në menaxhimin e financave publike dhe procesin e prokurimit; forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm komunal që sigurojnë mbikëqyrjen, monitorimin dhe sanksionimin e keqpërdorimeve dhe shkeljeve.
- **Ngritja e kapaciteteve** për rritjen e integritetit komunal, fuqizimi i zyrave komunale të prokurimit për ngritjen e kapaciteteve monitoruese, vlerësuese dhe raportuese të komunave në lidhje me prokurimin, rritja e kapaciteteve për kodet e etikës dhe masat e posaçme kundër korrupsionit për zyrtarët e prokurimit dhe/ose nevoja të tjera prioritare të identifikuara në planet për zhvillim të kapaciteteve komunale.
- **Trajnime** të bazuara në Vlerësimin e Nevojave që do të përfshijnë trajnime/punëtori për përdorimin e kriterëve MEAT (tenderi ekonomikisht më i favorshëm), përdorimin e moduleve për menaxhim të kontratave dhe vlerësim të performancës së kontratës, trajnime për menaxhimin e ndryshimeve për kryetarët e komunave dhe drejtuesit e zyreve të prokurimit, komunikimin me publikun, angazhimin e komunikimit dhe mediave, angazhimin e shoqërisë civile, etikën, integritetin e qeverisjes, llogaridhënien, zbulimin e mashtrimit dhe prioritete të tjera të identifikuara në planet për zhvillim të kapaciteteve komunale.
- **Rritja e mbështetjes, koordinimit dhe bashkëpunimit** me subjektet e nivelit qendror (si Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Ministria e Financave, Agjencia Kundër Korrupsionit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Njësia Qëndrore Harmonizuese, etj.) që janë relevante për mbështetjen, monitorimin dhe ofrimin e mbikëqyrjes për komunat në fushat e prokurimit, duke përfshirë menaxhimin e kontratave, menaxhimin financiar dhe auditimin.

- **Rritja e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe lokal** për t'i monitoruar komunat në fusha si prokurimi, duke përdorur dhe analizuar informacionin të disponueshëm për publikun për poentim të rezultateve, për të theksuar korrupsionin dhe në përgjithësi, për të hedhur më shumë dritë mbi qeverisjen komunale në proceset e prokurimit.
- **Numër të kufizuar të granteve të vogla** për aktivitete të vogla të nivelit komunal, por me ndikim të lartë, që promovojnë integritetin dhe llogaridhënien. Këto aktivitete do të kërkojnë një kontribut nga komuna prej të paktën 20% të vlerës totale të grantit.

## 5. VEPRIMET E KOMUNËS

Komuna synon:

- **Të lehtësojë qasjen** e stafit të DAI-t në drejtoritë dhe zyret, komisione të kuvendit komunal, dhe të sigurojë pjesëmarrjen dhe mbështetjen e stafit për aktivitetet e Aktivitetit KMI. Kjo përfshin qasjen në të gjitha dokumentet e brendshme komunale sipas nevojës.
- **Të marrë pjesë në programet e trajnimit, zhvillimin e kapaciteteve dhe aktivitetet e asistencës teknike** të organizuara nga partneri zbatues i USAID-it, DAI, dhe t'i përhapë mes komunave në fokus dhe jo në fokus, praktikat më të mira komunale dhe mësimet e nxjerra.
- **Të inkurajojë bashkëpunimin në kohën e duhur të zyrtarëve komunalë** për plotësimin e aktiviteteve të kërkuara, duke siguruar qasje në të gjitha të dhënat dhe informacionin e kërkuar.
- **Të zhvillojë dhe zbatojë plane të punës së komunës** së bashku me DAI-n, duke targetuar nevojat dhe kërkesat e komunës për arritjen e suksesit të matshëm.
- **Kontributi i komunës** prej së paku 20% për zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta të nivelit komunal që promovojnë integritetin dhe llogaridhënien.
- **Të ofrojë një mjedis të favorshëm për stafin e DAI** duke caktuar hapësirë të dedikuar në lokalet e Komunës për Këshilltarët Komunalë të projektit.

## 6. KOORDINIMI DHE KONSULTIMI

Pjesëmarrësit planifikojnë t'i japin njëri-tjetrit informacionin e nevojshëm për të lehtësuar asistencën dhe për të vlerësuar efektshmërinë e asistencës. Pjesëmarrësit planifikojnë gjithashtu të kërkojnë të takohen periodikisht për ta shqyrtuar asistencën dhe për të ndarë informata relevante. Pjesëmarrësit planifikojnë ta zgjidhin me konsultim ndërmjet Pjesëmarrësve çdo çështje në lidhje me interpretimin, administrimin ose zbatimin e këtij MM-je.

## 7. NJOFTIMET

Pjesëmarrësit synojnë që të gjitha njoftimet ose komunikimet në kuadër të këtij MM-je të jenë me shkrim me e-mail ose faks dhe të adresohen si më poshtë.

Pikat e kontaktit të njohura nga organizatat përkatëse janë:

**Për DAI-n:**

Agim Salihu

Udhëheqës i Objektivit 2 dhe 3

Rr. 24 Maji, Nr.7, Arbëri, Prishtinë

[agim.salihu@dai.com](mailto:agim.salihu@dai.com)

**Për Komunën:**

Remzi Ahmeti

Drejtor i Buxhetit, Financave dhe Thesarit

Rr. Isa Boletini, Nr. 10, Vushtrri

[remzi.n.ahmeti@rks-gov.net](mailto:remzi.n.ahmeti@rks-gov.net)

Secili Pjesëmarrës mund të ndryshojë pikën e vet të kontaktit duke i dërguar njoftim me shkrim Pjesëmarrësit tjetër.

## 8. PARIMET UDHËZUESE

- A. Efekti i MM-së.** Pjesëmarrësit pranojnë se ky MM nuk është traktat dhe nuk krijon të drejta ose detyrime sipas ligjit ndërkombëtar dhe se ky MM nuk përbën obligim për fonde dhe nuk ka për qëllim të përbëjë një zotim ligjërish të detyrueshëm nga ndonjë Pjesëmarrës apo të krijojë ndonjë të drejtë për ndonjë palë të tretë. Bashkëpunimi ndërmjet pjesëmarrësve, siç përshkruhet në këtë MM, nuk synon të krijojë një partneritet ose lloj tjetër të subjektit ose personalitetit juridik. Secili Pjesëmarrës synon të pranojë përgjegjësinë e plotë dhe të vetme për secilin dhe të gjitha shpenzimet e bëra nga ai vetë në lidhje me këtë MM. Pjesëmarrësit synojnë të mbajnë misionet dhe mandatet e tyre të veçanta dhe unike dhe llogaridhëniet e tyre. Ky MM pasqyron të gjithë mirëkuptimin dhe pajtimin e Pjesëmarrësve në lidhje me lëndën dhe mbizotëron ndaj çdo marrëveshjeje të mëparshme ose të njëkohshme me shkrim ose me gojë në lidhje me të. Asgjë në këtë MM nuk synon të krijojë një marrëdhënie ekskluzive pune.
- B. Publiciteti.** Pjesëmarrësit e kuptojnë se secili Pjesëmarrës mund ta bëjë publike ekzistencën dhe përmbajtjen e këtij MM-je, duke përfshirë njoftimin për shtyp, komentimin publik ose mjete të tjera për shpalosje, në përputhje me politikën dhe procedurat e veta. Nga DAI pritet të sigurojë pajtueshmërinë me çdo kërkesë të markës dhe brendimit sipas termave të kontratës së vet me USAID-in, duke përfshirë përdorimin e logos së Komunës aty ku është e përshtatshme për t'i njohur përpjekjet e Komunës.
- C. Modifikimi.** Ky MM mund të modifikohet me shkrim nga Pjesëmarrësit. Secili Pjesëmarrës mund të tërhiqet nga ky MM duke i dërguar Pjesëmarrësit tjetër njoftim paraprak 30 ditore me shkrim.

**D. Kohëzgjatja.** Ky MM fillon në datën e nënshkrimit nga Pjesëmarrësit dhe vazhdon deri më 20 mars 2027.

Ky MM mund të zgjatet me shkrim, me nënshkrimin nga të dy Pjesëmarrësit për çdo periudhë kohore.

**E. Përfaqësuesit.** Pjesëmarrësit synojnë që secili Pjesëmarrës të përfaqësohet nga bartësit ose ushtruesit e detyrave të nënshkruesve të këtij MM-je. Pjesëmarrësit synojnë që secili Pjesëmarrës, me anë të njoftimit me shkrim për tjetrin, të identifikojë përfaqësues shtesë të autorizuar për ta përfaqësuar atë Pjesëmarrës për të gjitha qëllimet, përveç modifikimeve të këtij MM-je. Pjesëmarrësit synojnë që secili Pjesëmarrës ta njoftojë me shkrim tjetrin për ndryshimet e përfaqësuesve të autorizuar.

**F. Gjuha.** Ky memorandum është përgatitur në gjuhën angleze, shqipe dhe sërbe.

**G. Ligji qeverisës dhe zgjidhja e kontesteve.** Kjo Marrëveshje do të qeveriset, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e shtetit të Maryland-it, pa marrë parasysh rregullat e tij për konflikt të ligjeve. Të dyja Palët pajtohen që, nëse lind ndonjë kontest në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, ato fillimisht do të përipiqen t'i zgjidhin këto konteste në mënyrë miqësore përmes negociatave. Nëse negociatat nuk rezultojnë efektive për zgjidhjen e ndonjë konflikti mes Palëve, ky kontest do të zgjidhet përmes arbitrazhit detyrues në Maryland.

Pjesëmarrësit, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të vet të autorizuar rregullisht, kanë bërë të mundur që ky memorandum të nënshkruhet nën emrat e tyre dhe të dorëzohet më **27 korrik, 2022**.

**Për DAI GLOBAL, LLC**

---

Emri: Stephen Carpenter

Titulli: Zv. President, Qeverisje

Data: 27/07/2022

**Për Komunën e Vushtrrisë**

---

Emri: Ferit Idrizi

Titulli: Kryetar

Data: 27/07/2022

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 996-1/22

Nr. i fq. / Br. sf -06-

Data: / Datum 27.07.2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



**USAID | KOSOVO**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



Komuna e Vushtrrië  
Opština Vuçitrn  
Municipality of Vushtrri

**MEMORANDUM OF UNDERSTANDING**

**BETWEEN**

**DAI GLOBAL, LLC**

**AND**

**THE MUNICIPALITY OF VUSHTRRI/ VUÇITRN**

**REGARDING THE  
KOSOVO MUNICIPAL INTEGRITY (KMI) activity**

This Memorandum of Understanding (hereinafter referred to as the "MOU") is entered into this 27<sup>th</sup> Day of July 2022 (hereinafter, the "Effective Date"), by and between DAI Global, LLC. (hereinafter referred to as the "DAI"), and the Municipality of Vushtrri/Vučitrn (hereinafter referred to as "Municipality"), collectively, referred to as the "Participants" and each singularly as the "Participant."

**WHEREAS**, it is the goal of DAI to collaborate with the Municipality in order to develop and roll out a model for ethics, integrity and accountable municipality, to engage the central level to address municipal corruption in the procurement, contract management, audit and PFM processes, and to enable civil society to track and expose corruption at the municipal level;

**WHEREAS**, it is the objective of DAI to collaborate with Municipality to increase integrity and accountability of the Municipality in the area of procurement process, financial management, internal auditing and contract management; and

**WHEREAS**, it is the objective of the Municipality to collaborate with DAI to improve integrity and accountability of the municipal procurement process, financial management, internal auditing and contract management; and

**NOW, THEREFORE**, the Participants intend to jointly collaborate on the following activities:

## **1. PURPOSE**

The purpose of this MOU is to formalize a collaboration between DAI, the contractor implementing the USAID-funded Kosovo Municipal Integrity Activity (hereinafter referred to as "KMI activity"), and the Municipality. By closely coordinating the efforts of DAI and Municipality under this MOU, both organizations intend to leverage their respective resources to achieve impacts that could not be achieved individually. DAI and Municipality are committed to the principles of good governance: rule of law, transparency, accountability, efficiency, effectiveness, responsiveness, inclusion, and citizen participation. Accordingly, the Participants have signed this MOU to set forth their proposed actions with respect to their support of this purpose.

## **2. BACKGROUND**

DAI is the contractor implementing the USAID-funded KMI activity which is a five-year project designed to support the Government of Kosovo (GoK) in implementing anti-corruption reforms. DAI, through the KMI activity, plans to address long-standing challenges related to corruption and poor-quality service delivery by the Government of Kosovo by enhancing public financial management (PFM), with a focus on municipal procurement, and by reinforcing accountability mechanisms both within government and outside of government through civil society, the private sector, and media, by improving the integrity and accountability of the municipal procurement process in all 38 municipalities of Kosovo, and providing comprehensive assistance to eight focus municipalities. DAI plans to achieve the objectives of the KMI activity through day-to-day mentoring, training, and coaching and



thereby institute systems that intend to improve the accountability of public funds and expenditures.

### 3. AREAS OF PLANNED TECHNICAL ASSISTANCE

The KMI Activity intends to address the needs of the Municipality following an assessment based on the Needs Gap Analysis that was facilitated by DAI. The specific assistance to be provided by DAI in its implementation of the KMI activity will be specified in the Municipal Work Plan, which will be agreed upon by the Mayor and the Municipal Assembly Chairperson of Vushtrri/Vučitrn and DAI. The Municipal Work Plan is broadly described in Section 4 of this MOU.

### 4. DAI's PLANNED ROLE

DAI intends to provide the following support to the Municipality:

- **Customized technical assistance** provided through on-the-job coaching and training regarding the procurement cycle, including project planning, project design and documentation, planning solicitations, tendering, evaluating bids, contract award, accounting and auditing, contract management, e-information, e-sourcing, e-tendering, and all other areas of the procurement cycle, and thereby putting anti-corruption safeguard mechanisms in place throughout the process.
- **Establish mechanisms** to enhance accountability in public finance management and the procurement process; strengthening municipal internal control mechanisms that ensure oversight, monitoring and sanctioning malfeasance and non-compliance.
- **Capacity-building** to increase municipal integrity, strengthen municipal procurement offices to build monitoring, evaluation, and reporting capacities of municipalities on procurement, increase capacities on codes of ethics and special anti-corruption measures for procurement officers, and/or other priority needs identified in municipal capacity development plans.
- **Training** based on the Needs Gap Analysis will include trainings/workshops for the use of MEAT (Most Economically Advantageous Tender) criteria, using contract management and contract performance evaluation modules, change management training for mayors and procurement heads, public outreach, communications, and media engagement, civil society engagement, ethics, government integrity, accountability, fraud detection and other priorities identified in municipal capacity development plans.
- **Increase support, coordination, and collaboration** with the central level entities (such as the Public Procurement Regulatory Commission, Procurement Review Body, Ministry of Finance, Anti-Corruption Agency, National Audit Office, Central Harmonization Department, etc.) that are relevant to supporting, monitoring, and providing oversight to the municipalities in the areas of procurement, including contract management, financial management and auditing.

- **Increase capacities of national and local level civil society organizations** to monitor municipalities, in areas such as procurement by using and analyzing publicly available information to create scorecards, highlight corruption, and generally, shed more light on municipal governance in the procurement processes.
- **Limited number of small grants** for small, high impact, municipal level activities that promote integrity and accountability. These activities will require a municipal contribution of at least 20% of the total value of grant.

## 5. MUNICIPAL ACTIONS

Municipality intends to:

- **Facilitate access** of the DAI staff to municipal directorates and units, municipal assembly committees, and ensure staff participates in and supports activities of the KMI project. This includes access to all internal municipal documents as needed.
- **Participate in training programs, capacity-development, and technical assistance activities** organized by USAID implementing partner DAI and disseminate best municipal practices and lessons learned among its focus and non-focus municipalities.
- **Encourage timely collaboration of municipal officials** in completing required activities, ensuring access to all the data and information required.
- **Develop and implement municipal work plans** together with DAI targeting municipal needs and requirements for achieving measurable success.
- **Municipal contribution** of at least 20% for implementation of joint municipal level activities that promote integrity and accountability.
- **Provide an enabling environment for DAI staff** by assigning dedicated space in the Municipality for the project's Municipal Advisors.

## 6. COORDINATION AND CONSULTATION

The Participants plan to provide each other with the information needed to facilitate assistance and to evaluate the effectiveness of the assistance. The Participants plan to also request to meet periodically to review assistance and share relevant information. The Participants plan to resolve any issues concerning the interpretation, administration, or implementation of this MOU by consultation between the Participants.

## 7. NOTICES

The Participants intend that all notices or communications under this MOU be in writing by email or facsimile and addressed as follows.

The respective organizational cognizant points of contact are:

**For DAI:**

Agim Salihu

Udhëheqës i Objektivit 2 dhe 3

Rr. 24 Maji, Nr.7, Arbëri, Prishtinë

[agim.salihu@dai.com](mailto:agim.salihu@dai.com)

**For Municipality:**

Remzi Ahmeti

Director of the Budget, Finance and  
Thesaurus

Str. Isa Boletini, No. 10, Vushtrri

[remzi.n.ahmeti@rks-gov.net](mailto:remzi.n.ahmeti@rks-gov.net)

Each Participant may change its cognizant point of contact by written notice to the other.

## 8. GUIDING PRINCIPLES

- A. Effect of MOU.** The Participants recognize that this MOU is not a treaty and does not give rise to rights or obligations under international law, and that this MOU is not an obligation of funds and is not intended to constitute a legally binding commitment by any Participant or create any rights in any third party. The cooperation among the Participants as outlined in this MOU is not intended to create a partnership or other type of legal entity or personality. Each Participant intends to accept full and sole responsibility for any and all expenses incurred by itself related to this MOU. The Participants intend to maintain their own separate and unique missions and mandates and their own accountabilities. This MOU reflects the entire understanding and agreement of the Participants with respect to the subject matter and supersedes any prior or contemporaneous written or oral agreements thereon. Nothing in this MOU is intended to create an exclusive working relationship.
- B. Publicity.** The Participants understand that each Participant may make the existence and content of this MOU publicly available, including by press release, public commentary, or other means of disclosure, in accordance with its own policies and procedures. It is anticipated that DAI will ensure compliance with any branding and marking requirements per the terms of its contract with USAID, including use of the Municipal logo where appropriate to attribute the efforts of the Municipality.
- C. Modification.** This MOU may be modified in writing by the Participants. Each Participant may withdraw from this MOU by giving the other Participant thirty (30) days written notice.
- D. Duration.** This MOU begins on the date of signature by the Participants and continues until March 20, 2027.

This MOU may be extended in writing signed by both Participants for any period of time.

**E. Representatives.** The Participants intend that each Participant be represented by those holding or acting in the offices held by the signatories to this MOU. The Participants intend that each Participant may, by written notice to the other, identify additional representatives authorized to represent that Participant for all purposes other than modifications to this MOU. The Participants intend that each Participant is to notify the other in writing of changes in the authorized representatives.

**F. Language.** This Memorandum of Understanding was written in English (the prevailing language) and translated into Albanian and Serbian.

**G. Governing Law and Dispute Resolution.** This Agreement shall be governed, interpreted, and enforced in accordance with the laws of the State of Maryland, without regard to its conflict of laws rules. Both Parties agree that, should any disputes arise under this Agreement, they will first endeavor to resolve such disputes amicably through negotiation. If negotiations do not prove effective in resolving any conflict between the Parties, such dispute shall be resolved through binding arbitration in Maryland.

The Participants, each acting through its duly authorized representative, have caused this MOU to be signed in their names and delivered as of **July 27, 2022**.

**For DAI GLOBAL, LLC**



Name: Stephen Carpenter

Title: Vice President, Governance

Date: July 27, 2022

**For Municipality of Vushtrri/Vučitrn**



Name: Perit Idrizi

Title: Kryetar

Date: July 27, 2022